



REPUBLIKA KOSOVË - REPUBLIC OF KOSOVO
DOKUMENTI I PËRQITËS SË DOKUMETIT
DOKUMETI ëShtë i përgjithshëm, i lirë
dokumenti i përmirësimi i vlerësimit e konsistencës
LIGJIT PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË PROKURORËVE
PRISTINA - 24 - 10 - 2013
Nr. 1186/2013

Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilaški Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial
Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke u bazuar në nenet 4, 15 dhe 21 të Ligjit për
Këshillin Prokurorial të Kosovës, nxjerr këtë:

Rregullore për Vlerësimin e Përformancës së Prokurorëve

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Fushëveprimi i Rregullores

Kjo rregullore është e zbatueshme për të gjithë Prokurorët e Shtetit në Kosovë.

Neni 2 Qëllimi i rregullores

1. Qëllimi i kësaj rregullore është:

- 1.1 Vlerësimi dhe përmirësimi i performancës së Prokurorëve;
- 1.2 Përcaktimi i mënyrës së kryerjes së vlerësimit; dhe
- 1.3 Themelimi i Komisionit përkatës për sigurimin e konsistencës në vlerësimin e Prokurorëve në Kosovë.

Neni 3
Parimet e Vlerësimit

1. Vlerësimi duhet të kryhet në përputhshmëri me parimet e ligjshmërisë, barazisë, objektivitetit, transparencës dhe do të garantojë mundësi të barabarta dhe të drejtë për zhvillimin e karrierës së prokurorëve.
2. Vlerësimi do të kontribuojë në sigurimin e llogaridhënieve në sistemin prokuroria si dhe të ngritë integritetin, efektivitetin dhe cilësinë e Prokurorëve.
3. Vlerësimi nuk ndërhyr në pavarësinë dhe paanshmërinë e prokurorëve.

Neni 4
Periudha e Vlerësimit

1. Prokurorët vlerësohen dy herë para marrjes së vendimit për emërimin e përhershëm të tyre, së pari pas periudhës fillestare prej 18 muajve dhe në fund të periudhës tri (3) vjeçare, gjashtë muaj para fillimit të periudhës së riemërimit.
2. Vlerësimi i rregullt i të gjithë prokurorëve me emërim te përhershëm bëhet çdo tri (3) vite.
3. Njësiti për Shqyrtimin e Performances se Prokuroreve cakton listën e prokuroreve qe do te vlerësohen për çdo vit paraprak pas konsultimit me Kryetarin e Komisionit për Vlerësim.
4. Vlerësimi i rregullt i performances se 1/3 te prokuroreve me mandat te përhershëm bëhet çdo vit kalendarik sipas rotacionit.

KREU II
KRITERET E VLERËSIMIT DHE BURIMET E INFORMACIONIT

Neni 5
Kriteret e Vlerësimit

1. Vlerësimi i performancës së Prokurorëve bëhet sipas kritereve të përcaktuara në Ligjin për KPK dhe me këtë Rregullore.
2. Sa i përket Kryeprokurorëve, treguesit shtesë në vijim do të shërbejnë si bazë për vlerësimin e aftësive menaxhuese dhe organizative dhe përvojës së tyre:
 - 2.1 Kapaciteti për trajtimin e lëndëve të caktuara;
 - 2.2 Aftësitë organizative;
 - 2.3 Aftësitë menaxhuese dhe udhëheqëse;
 - 2.4 Shfrytëzimi efektiv i burimeve, siç janë buxheti, objektet ose pajisjet;

- 2.5 Aftësia për caktimin e objektivave dhe implementimin e tyre;
- 2.6 Aftësitë për zgjidhjen e problemeve, posaçërisht problemeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe materiale.
3. Treguesit e renditur në nën-paragrafët 2.1, 2.2, 2.4 dhe 2.5 aplikohen në mënyrë analoge edhe për Prokurorët Mbikëqyrës ose në përgjithësi për prokurorët që ushtrojnë detyra menaxhuese.

Neni 6
Burimet e Informacionit

1. Gjatë procesit të vlerësimit do të përdoren disa burime të informacionit që përfshijnë:
- 1.1 Dosja personale e Prokurorit;
- 1.2 Raporti Vlerësues i Kryeprokurorit;
- 1.3 Raportet vjetore te Kryeprokurorëve;
- 1.4 Raporti i Vet-Vlerësimit i Prokurorit;
- 1.5 Rastet e zgjedhura në mënyrë të rastësishme;
- 1.6 Raportet e rregullta të Kryeprokurorëve ose Prokurorëve Mbikëqyrës;
- 1.7 Rastet e zgjedhura nga Prokurori;
- 1.8 Vendimet disiplinore të formës së prerë, në rast të dënimit;
- 1.9 Informatat statistikore të siguruara nga Njësiti;
- 1.10 Çdo dokument tjetër që përmban informata objektive dhe relevante për veprimtarinë profesionale dhe sjelljen personale që ndikon në veprimtarinë profesionale të prokurorit, që mund të merret parasysh nga Komisioni Vlerësues.
2. Mënyra e zgjedhjes së rastësishme të rasteve do të bëhet si vijon:

Komisioni i Vlerësimit çdo vit do të térheqë me short lëndët nga një gjashtë-mujorësh(ose një muaj)nga viti i kaluar. Njësiti do t'i grumbullojë dhe i dorëzon Komisionit për Vlerësim të gjitha vendimet të ndërmarrë gjatë kësaj periudhe nga prokurori i vlerësuar.

Neni 7
Raporti i vlerësues i kryeprokurorit

1. Secili kryeprokuror në baza vjetore, do të vlerësoj performancën e secilit prokuror që punon në zyrën e tyre.
2. Qëllimi i vlerësimit të bërë nga kryeprokurori është të:
- 2.1 Të vlerësoj performancën e prokurorit;
- 2.2 Identifikojë mangësitë e performancës;
- 2.3 Përkrahë prokurorët në përmirësimin e perfomancës së tyre;
3. Raporti i vlerësimit të performancës i Kryeprokurorit do të përfshij:

- 3.1 Vlerësimin e prokurorit për vitin e kaluar në përputhshmëri me kriteret dhe treguesit siç janë përcaktuar me këtë Rregullore dhe formën e vendosur në Shtojcën 2;
 - 3.2 Propozimin e nevojave për trajnim;
 - 3.3 Propozimin e qëllimeve përmirësimin e performancës
4. Kryeprokurori do ta takojë secilin prokuror individualisht para se të dorëzojë raportin.

Neni 8
Burimet e informacionit përvlerësimin e Kryeprokurorëve

1. Përvlerësimin e Kryeprokurorëve dhe te prokuroreve me detyra menaxhuese do te përdoren disa burime te informacionit lidhur me administrimin dhe menaxhimin e Prokurorisë përkatëse, duke përfshire:
 - 1.1 Plani Vjetor i Prokurorisë përkatëse;
 - 1.2 Mbledhja Vjetore e Kryeprokurorëve;
 - 1.3 Raportet Tremujore të Kryeprokurorëve;
 - 1.4 Raporti i NJSHP për Prokurorinë përkatëse;
 - 1.5 Raportet e rregullta të Kryeprokurorëve;
 - 1.6 Çdo dokument tjeter që përmban informata objektive dhe relevante për veprimtarinë profesionale dhe sjelljen personale që ndikon në veprimtarinë profesionale të prokurorit, që mund të merret parasysh nga Komisioni Vlerësues.

KREU III
TREGUESIT PËR VLERËSIM

Neni 9
Njohuria profesionale, përvoja e punës dhe performanca, duke përfshire njohjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut

1. Ky kriter vlerësohet në bazë të treguesve kuantitativ dhe kualitativ në vijim:
 - 1.1 Treguesit kuantitativ përmes matjen e këtij kriteri janë si vijon:
 - a. Niveli i plotësimit të normës vjetore duke marrë parasysh kompleksitetin e lëndëve në vlerësim;
 - b. Raportin mes kallëzimeve penale të pranuara dhe të hudoara;
 - c. Raportin mes aktakuzave të pranuara, të kthyera përmes plotësim dhe te refuzuara;
 - d. Raportin mes aktakuzave të parashtruara dhe vendimeve gjykuese dhe liruese;
 - e. Raportin mes ankesave të aprovuara dhe të refuzuara kundër vendimeve/aktgjykimeve të gjykatës;
 - f. Raportin mes ankesave të aprovuara dhe/ose refuzuara kundër aktgjykimeve;
 - g. Raportin mes mjeteve të jashtëzakonshme juridike të aprovuara dhe të refuzuara që janë parashtruar;

1.2 Treguesit cilësor për matjen e këtij kriteri janë si vijon:

- a. Aftësia për arsyetimin e kërkesave për caktimin e masave; (paraburgimi, arresti shtëpiak, etj).
- b. Aftësia për inicimin/pezullimin e hetimeve;
- c. Aftësia për kualifikimin adekuat të veprës penale;
- d. Aftësia për mbrojtjen e rastit para gjykatës; dhe
- e. Përvaja e punës.

Neni 10

Kapaciteti dhe aftësia për analizimin e problemeve ligjore dhe zotësia për arsyetim ligjor

1. Ky kriter do të vlerësohet në bazë të treguesve në vijim:

- 1.1 Njohja e ligjeve të aplikueshme;
- 1.2 Aftësia për kualifikimin e veprave penale në mënyrë adekuate;
- 1.3 Aftësia për përfshirjen e fakteve sipas dispozitave përkatëse;
- 1.4 Aftësia për analizimin e ligjeve sipas metodave sistematike dhe koherente
- 1.5 Kapaciteti për grumbullimin e provave/fakteve sipas implikimeve ligjore;
- 1.6 Kapaciteti për vlerësimin dhe arsyetimin e provave të grumbulluara lidhur me veprën penale.

Neni 11

Aftësia profesionale

1. Ky kriter do të vlerësohet në bazë të treguesve në vijim:

- 1.1 Vetriniciativa;
- 1.2 Puna ekipore;
- 1.3 Aftësia për menaxhimin e rasteve dhe kohës;
- 1.4 Shkathësia e marrjes ne pyetje (drejtpërdrejtë dhe tërthorte);
- 1.5 Përdorimi i teknologjisë informative;
- 1.6 Personaliteti i fortë dhe vetë-kontrolli;
- 1.7 Gatishmëria për të zhvilluar shkathësitë profesionale përmes trajnimeve;
- 1.8 Pjesëmarja në aktivitete tjera (tryeza pune, grupe punuese, etj.)
- 1.9 Gatishmëria për zëvendësimin e prokurorëve tjera;
- 1.10 Kapaciteti për marrjen e iniciativës në rastet e tjera kur vepron si prokuror zëvendësues; dhe
- 1.11 Gatishmëria për të punuar ne Kujdestari(si prokuror "Kujdestar").

Neni 12

Aftësia për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, ndërgjegjshme, me zell, vendosmëri dhe përgjegjësi

1. Ky kriter do të vlerësohet në bazë të treguesve në vijim:

- 1.1 Pavarësia dhe paanshmëria;
- 1.2 Ndershëmëria, sinqeriteti dhe besueshmëria;
- 1.3 Sjellja e mirë dhe karakteri
- 1.4 Fuqia e personalitetit dhe vetëkontrolli;
- 1.5 Respektimi i Kodit të Etikës.

Neni 13

Aftësitë e komunikimit

1. Ky kriter do të vlerësohet në bazë të treguesve në vijim:

- 1.1 Aftësia për sigurimin e saktësisë, qartësisë dhe njëtrajtshmërisë në dokumentet e shkruara;
- 1.2 Aftësia për paraqitjen e fakteve në seanca dëgjimore dhe për shprehjen e shqyrtimeve në seanca gjyqësore;
- 1.3 Aftësia për ndërveprimin me publikun dhe palët në procedurë në mënyrë profesionale.

Neni 14

Sjelljet jashtë zyrës

1. Ky kriter do të vlerësohet në bazë të treguesve në vijim:

- 1.1 Respektimi i standardeve të sjelljes brenda dhe jashtë zyrës për aq sa ndikon në veprimtarinë profesionale të prokurorit;
- 1.2 Vlerësimi i aktiviteteve plotësuese
- 1.3 Vlerësimi i konflikteve eventuale të interesit.

Neni 15

Integriteti personal

1. Ky kriter do të vlerësohet në bazë të treguesve në vijim:

- 1.1 Dinjiteti, sinqeriteti, besueshmëria;
- 1.2 Respektimi i shumëlojshmërisë;
- 1.3 Përshtatshmëria.

KREU IV

METODAT E VLERËSIMIT

Neni 16

1. Vlerësimi i përgjithshëm i Prokurorëve do të bëhet në bazë të vlerësimit të punës sipas kritereve të përcaktuara në ligj dhe treguesve përkatës.

Neni 17

Vlerësimi kuantitativ i punës së prokurorëve do të bazohet në të dhënrat statistikore dhe nivelit të plotësimit të normës vjetore siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ mbi normën orientuese vjetore për punën e Prokurorëve duke marrë parasysh kompleksitetin e rasteve nën vlerësim.

KREU V KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCES SË PROKUROREVE (KVPP)

Neni 18 Mandati

1. Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve është komision i përhershëm në KPK, që është kompetent për kryerjen e procedurës së vlerësimit për të gjithë Prokurorët.

Neni 19 Kompetencat

1. Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve është kompetent për kryerjen e vlerësimit individual të performancës në bazë të procedurave të përcaktuara me ligj dhe këtë Rregullore dhe aktet tjera të miratuara në Këshill.
3. Në ushtrimin e aktiviteteve të tij, KVPP do të ketë qasje në informatat, dosjet, lëndët dhe statistikat e plota të Prokurorit që i nënshtronhet procesit të vlerësimit.
4. Pas përfundimit të vlerësimit, KVPP propozon notimin e prokurorit sipas niveleve: pamjaftueshëm, mjaftueshëm, mirë dhe shumë mirë.
5. KVPP nxjerr një raport përfundimtar me propozimin për vlerësim të Prokurorit përkatës, raport që dorëzohet në KPK, jo më shumë se një muaj pas marrjes se Vendimit për vlerësim.
6. KPK vendos për vlerësimin përfundimtar të Prokurorëve.

Neni 20 Përberja e Komisionit

1. KVPP përbëhet nga shtatë (7) anëtarë që zgjedhën nga KPK si vijon:
 - 1.1 Një anëtarë nga radhët e anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës, nga radhët e prokuroreve ne Këshill, i cili do te jetë Kryetar i komisionit;

- 1.2 Dy anëtarë do të zgjedhën nga radhët e prokurorëve të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit;
 - 1.3 Dy anëtarë nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit;
 - 1.4 Nje anëtar nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë Speciale.
 - 1.5 Nje anëtar nga radhët e prokuoreve te PTH.
1. KVPP do të ketë të paktën katër (4) anëtarë zëvendësues të cilët thirren në rast të mungesës së anëtarëve ekzistues për arsyen objektive ose nëse anëtarët ekzistues kanë konflikt interesë. Pas propozimit të Kryesuesit, Këshilli mundet të zëvendësojë përkohësisht një anëtar të Komisionit kur ai anëtar nuk e ka të mundshme të kryejë detyrën e tij/ saj.
 2. Anëtarët dhe anëtarët zëvendësues emërohen për një mandat tre (3) vjeçar me mundësi të ri-emërimit vetëm edhe një herë tjetër. Dy (2) anëtarët dhe një (1) anëtar zëvendësues nga përbërja e parë, që emërohen në mënyrë të rastësishme, do të kenë edhe një (1) mandat tjetër shpeshtë një (1) vjeçar.
 3. Mandati i anëtarit te Komisionit është i lidhur me pozitën sipas se cilës është caktuar anëtar i Komisionit.
 4. KPK do të themelojë Komisionin për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve brenda pesëmbëdhjetë 15 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulllore.
 5. KPK do të ketë marrë parasysh strukturën etnike, gjinore dhe territoriale gjatë zgjedhjes së anëtarëve të KVPP.

**Neni 21
Kryetari**

1. Komisioni kryesoitet nga Kryetari.
2. Komisioni zgjedh zëvendëskryetarin e Komisionit.
3. Zëvendëskryetari ka te gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryetarit ne mungese te tij.

**Neni 22
Mbështetja për KVPP**

1. Njësiti do të i ofrojë mbështetje KVPP.
2. Njësiti do të mbledhë dhe përgatisë të gjitha informatat statistikore dhe informatat e tjera të nevojshme kur kërkohen nga KVPP.
3. Gjatë procesit të vlerësimit, Njësiti do të përgatisë raportet individuale për secilin prokuror të cilat ia dorëzon Komisionit Vlerësues.

Neni 23
Mbledhjet e Komisionit

1. Mbledhjet e Komisionit zhvillohen sipas nenit 31 të Rregullores për Funksionet dhe Veprimtarinë e KPK.

Neni 24
Votimi

1. Vendimet e Komisionit merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të Komisionit.
2. Vendimin për vlerësim e nënshkruajnë te gjithë anëtaret e Komisionit.

KREU VI
RREGULLAT E PROCEDURËS

Neni 25
Raportimi

1. Çdo prokuror duhet të siguroj informata për punën e tij/saj në regjistrin online të përgatitur nga Njësiti, sipas rregullave dhe procedurave të përpiluara nga NJSHPP për performancën e tij/saj.
2. Në bazë të raporteve të dorëzuara nga prokurori dhe Raportet vjetore të kryeprokurorit, Njësiti do mbledh të gjitha raportet dhe informatat për prokurorin i cili i nënshtrohet procedurës së vlerësimit dhe i dorëzon te Komisioni për Vlerësim, për vlerësim te prokurorit.

Neni 26
Inicimi i Procedurës së Vlerësimit

1. NJSHPP rregullisht informon Kryetarin e Komisionit Vlerësues lidhur me Prokurorët që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit.
2. NJSHPP përgatit një listë të Prokurorëve që do t'i nënshtrohen vlerësimit dhe ia dorëzon atë Kryetarit të Komisionit së paku nëntë (9) muaj para skadimit të mandateve sipas nenit 4, paragrafi 2.
3. Pas pranimit të listës së Prokurorëve që i nënshtrohen procesit të vlerësimit, Kryetari i Komisionit Vlerësues e informon se cilin Prokuror që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit.
4. NJSHPP përgatit dokumentacionin dhe informatat e nevojshme për vlerësimin e prokurorit gjatë mandatit fillestar si dhe e informon Komisionin Vlerësues.

5. Për qëllime të vlerësimit të rregullt që kryhet çdo tre (3) vite, NJSHP do të identifikojë në baza vjetore Prokurorët që duhet të vlerësohen në fund të cdo viti përkatës dhe e informon Kryesuesin e Komisionit Vlerësues për këtë.
6. Njësia do të sigurojë të gjitha informatat e nevojshme për kryerjen e vlerësimit.

Neni 27
Vetë-vlerësimi

1. Prokurori i cili i nënshtronhet procedurës së vlerësimit është i obliguar që t'i dorëzojë Komisionit Vlerësues raportin e vetë-vlerësimit sipas shtojcës 3, dhe tetë (8) rasteve të zgjedhura, jo më vonë se 15 ditë pune pas datës kur ai/ajo ka pranuar informatat nga Njësia.

Neni 28
Vlerësimi nga Kryeprokurori

1. Në bazë të njoftimit të NJSHP, të paraparë në nenin 28, kryeprokurori i dorëzon Komisionit Vlerësues një raport për secilin prokuror që punon në prokurorinë përkatëse deri me date 31 janar të vitit përkatës.
2. Formulari në Shtojcën 2 do të përdoret për secilin raport të vlerësimit. Dokumentet relevante për vlerësimin, duke përfshirë vetë-vlerësimin e Prokurorit sipas Shtojcës 3 dhe të gjitha vendimet relevante do të bashkëngjiten.

Neni 29
Vlerësimi nga Komisioni

1. Komisioni Vlerësues pas pranimit të informatave të nevojshme nga NJSHP, raportin e vlerësimit të Kryeprokurorit, vetë-vlerësimin e prokurorit dhe dokumentet tjera relevante, do të bëjë vlerësimin e Prokurorit.
2. Komisioni Vlerësues mund të kërkojë informata shtesë nga NJSHP, Kryeprokurori i Prokurorisë përkatëse ose nga vetë Prokurori. Prosesverbali i mbledhjes së Komisionit Vlerësues do t'i bashkëngjitet raportit përfundimtar.
3. Të gjitha informatat shtesë të kërkuara nga Komisioni Vlerësues do të sigurohen nga NJSHP. Duhet të sigurohet që NJSHP të ketë kompetencën për të kërkuar informatat e nevojshme nga institucionet e ndryshme në kuadër të Shërbimit Prokurorial.
4. Komisioni Vlerësues, i përfaqësuar nga një reportues, do të nxjerrë një raport përfundimtar me propozimin për rangimin e Prokurorit përkatës sipas formularit në Shtojcën 1, brenda një muaji pas pranimit të dosjes nga NJSHP.
5. Raporti i vlerësimit të Komisionit Vlerësues së bashku me propozimin për rangimin (gradimin) e Prokurorit do t'i dorëzohet ne te njëjtën kohe KPK për vendosje përfundimtare dhe prokurorit ndaj te cilit është bere vlerësimi.

- Komisioni Vlerësues mund të rekomandojë KPK -se masa shtesë për përmirësimin e performancës së prokurorit.

Neni 30

Kundërshtimi i prokurorit për vlerësimin e Komisionit Vlerësues

Prokurori i vlerësuar ka të drejtë të kundërshtojë reportin e KVPP pranë KPK, duke përfshirë edhe kundërshtimin e komenteve lidhur me dokumentet ose vlerësimet e alduara në reportin përfundimtar brenda shtatë (7) ditëve pune pas pranimit të tij.

Neni 31

Vendimi i KPK

- KPK vendos për vlerësimin e Prokurorit sipas notave: pamjaftueshëm, mjaftueshëm, mirë dhe shumë mirë. Vendimi duhet të merret brenda pesëmbëdhjetë (30) ditëve pune pas pranimit të reportit, propozimit nga Komisioni Vlerësues dhe kundërshtimit te prokurorit ne rast kundërshtimi.
- KPK mund të kërkojë informata shtesë nga Kryeprokurori ose Prokurori i ngarkuar me detyra menaxhuese, Komisioni Vlerësues dhe të intervistojë Prokurorin. Procesverbali i çdo interviste deponohet në dosjen përkatëse.
- Vendimi i komunikohet Prokurorit së paku shtatë (7) ditë pune pas marrjes së vendimit dhe përfshihet në dosjen personale të Prokurorit.

Neni 32

Pasojet e vlerësimit të prokurorëve

- Kur vlerësimi i prokurorit është i nivelit të pamjaftueshëm gjatë dy viteve rradhazi, atëherë KPK mund të shqyrtojë atë si rast disciplinor dhe t'i paraqesë Zyrës së prokurorit disciplinor për inicim të procedurës disciplinore.
- Kur vlerësimi i prokurorit është mjaftueshëm paraqet shkak për dërgim të Prokurorit në trajnime të detyrueshme.
- Kur vlerësimi i prokurorit është shume mire, ky paraqet baze për avancim në pozitën e Prokurorit të nivelit më të lartë.
- Me rastin e propozimit të kandidatit për pozitën e kryeprokurorit, Këshilli Prokurorial i Kosovës, do ta merr për bazë notën dhe numrin e poenëve të prokurorit në fjalë, në pajtim me Rregulloren për Avancim.

KREU VII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 33
Njoftimi i KPK-se

Menjëherë pas miratimit të kësaj Rregullore, KPK do të njoftojë të gjitha Prokuroret lidhur me këtë Rregullore, duke përfshirë të gjitha shtojcat dhe formularët përkatës.


Neni 34
Konfidencialiteti

Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në ligjet dhe/ose rrugolloret tjera, të gjitha shënimet dhe informata që mbidhen ose mbahen gjatë procesit të vlerësimit janë konfidencale dhe nuk zbulohen, përveç nëse është kërkuar ndryshe nga Prokurori nën vlerësim.

Neni 35
Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi nga data 01 janar 2014, pas miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Miratuar më 18/10/2013


Ismet Kabashi
Kryetari i Këshillit Prokurorial

Shtojca I: Vlerësimi nga KVPP

Shtojca II: Raporti i Vlerësimit nga Kryeprokurori

Shtojca III: Raporti i Vetë-Vlerësimit



REPUBLIKA E KOSOVES/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KESHILLI PROKURORIAL I KOSOVES/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVË/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

SHTOJCA 1

Formular për vlerësimin e prokurorëve
(nga Komisioni Vlerësues)



REPUBLIKA E KOSOVES/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIK OF KOSOVA
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

FORMULAR I VLERËSIMIT

Dosja Nr. _____
Data: _____ / _____ / _____

PJESA I: INFORMATAT TË PËRGJITHSHME

(Informatat në Pjesën I duhet të plotësohen nga Komisioni Vlerësues)

Emri: _____

Data e Lindjes: _____

Pozita / Départamenti _____

1. PËRVOJA E PUNËS

(Shpjegim i shkurtër i përvojës së mëparshme të punës)

2. EDUKIMI

Aktivitetet relevante (pjesëmarrja si trajner, publikimet, etj.)

3. VLERËSIMET E MËPARSHME

Rezultatet nga dy vlerësimet e mëparshme:

Periudha		Vlerësimi
Nga	Deri	

4. KUALIFIKIMET E REJA TË FITUARA PAS VLERËSIMIT TË FUNDIT

5. TË DHËNAT DISIPLINORE

(Informata të shkurtta lidhur me procedurat disiplinore kundër prokurorit në rast se procedura ka përfunduar me dënim.)

PJESA II: VLERËSIMI NË BAZË TË KRITEREVE DHE TREGUESVE

NOTAT NË KËTË FORMULAR JANË SI VIJONI:

1. PAMIAFTUESHËM
2. MJAFTUESHËM
3. MIRË
4. SHUMË MIRË

	Nota			
	1	2	3	4
1. NJOHURIA PROFESSIONALE, DUKE PËRFSHIRË KUPTIMIN DHE RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT, PËRVOJA DHE PERFORMANCE, DUKE PËRFSHIRË VLERËSIMIN KUANTITATIV TË REALIZIMIT TË NORMËS	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Vlerësimi i treguesve sasior

Niveli i plotësimit të normës vjetore duke marrë parasysh kompleksitetin e lëndëve në vlerësim

Raportin mes kalkzimeve penale të pranuara dhe të huadhura;

Raportin mes aktakuzave të pranuara, të kthyera për plotësim dhe te refuzuara;

Raportin mes aktakuzave të parashtruara dhe vendimeve gjykuarës së lirues;

Raportin mes ankesave të aprovuara dhe të refuzuara kundër vendimeve/aktgykimeve të gjykatës;

Raportin mes ankesave të aprovuara dhe/ose refuzuara kundër aktgykimeve;

Raportin mes mjeteve të jashtëzakonshme juridike të aprovuara dhe të refuzuara që janë parashtruar;

Vleresimi i treguesve kualitativ:

Aftësia për arsyetimin e kërkesave për caktimin e masave; (paraburgimi, arresti shëpiak, etj).

Aftësia për iniciimin/pezullimin e hetimeve;

Aftësia për kualifikimin adekuat të vepres penale;

Aftësia për mbrojtjen e rastit para gjykatës;

Përvoda e punës

Komenti lidhur me burimet e informacionit të përdorura dhe konkludimet; më theks të veqantë në vendimet e dërtzuara;

Nota

1 2 3 4

2. KAPACITETI DHE AFTËSIA PËR ANALIZIMIN E PROBLEMEVE LIGJORE DHE ZOTËSIA PËR ARSYETIM LIGJOR

Njohja e ligjeve të aplikueshme;

Aftësia për kualifikimin e veprave penale në mënyrë adekuate;

Aftësia për përfshirjen e fakteve sipas dispozitave përkatëse;

Aftësia për analizimin e ligjeve sipas metodave sistematike dhe koherente

Kapaciteti për grumbullimin e provave/fakteve sipas implikimeve ligjore;

Kapaciteti për vlerësimin dhe arsyetimin e provave të grumbulluara lidhur me veprën penale.

	<u>Nota</u>			
	1	2	3	4
3. AFTËSIA PROFESIONALE	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Vetë-Iniciativa

Puna ekipore

Aftësia për menaxhimin e rasteve dhe kohës

Shkaktësia e marrjes në pyetje (drejtperdrejte dhe terthorte)

Përdorimi i teknologisë informative

Personaliteti i fortë dhe vetëkontrolli

Gatishmëria për të zhvilluar shkaktësitë profesionale përmes trajnimeve

Pjesemarja ne aktivitete tjera (trycza pune, grupe punuese, etj)

Gatishmeria per zevendesimin e prokuoreve tjere

Kapaciteti per marrjen e iniciativës ne rastet e tjera kur vepron si prokuror zevendesues

Gatishmenia per te punuar ne kujdestari (si prokuror "kujdestar")

Komenti lidhur me burimet e informacionit te përdorura dhe konkludimet me theks te veçantë ne vendimet e dorëzuara:

	Nota			
	1	2	3	4
5. AFTËSIA PËR KRYERJEN E DETYRAVE TË MËNYRË TË PAANSHME, NDËRGJEGJSHME, ME ZELL, VENDOSMËRI DHE PËRGJEGJËSI	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Pavarësia dhe paanshmëria

Ndershmëria, singeriteti dhe besueshmëria

Sjellja e mirë dhe karakteri

Fuqia e personalitetit dhe vetëkontrolli

Respektimi i Kodit të Etikës.

	Nota			
	1	2	3	4

6. AFTËSITË E KOMUNIKIMIT

Aftësia për sigurimin e saktësisë, qartësisë dhe një trajtshmërisë në dokumentet e shkruara;

Aftësia për paraqitjen e fakteve në seanca dëgjimore dhe pët shprehjen e shqyrtimeve në seanca gjyqësore;

Aftësia për adérveprimin me publikun dhe palët në procedurë në mënyrë profesionale dhe të sjellshme;

	Nota			
	1	2	3	4

7. SJELLJA JASHTË ZYRËS

Respektimi i standardeve të sjelljes brenda dhe jashtë zyrës për aq sa ndikon në veprimtarinë profesionale të Prokurorit;

Vlerësimi i aktiviteteve plotësuese;

Vlerësimi i konfliktit eventual të interesit;

	Nota			
	1	2	3	4
8. INTEGRITETI PERSONAL	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Etika

Dinjiteti, ndershmëria, besueshmëria;

Respektimi i diversitetit

Përshtatshmëria

	Nota			
	1	2	3	4

9. AFTESITË MENAXHUESE (NËSE ËSHTË E APLIKUESHME)

(Kjo pjesë duhet të plotësohet nga Komisioni i Vlerësimit për vlerësimin e Kryeprokurorëve siç është përcaktuar në Nenin 5.2 të Rregullores)

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------

Kapaciteti për trajtimin e lëndëve të caktuara;

Aftesitë organizative;

Aftesitë menaxhuese dhe udhëheqëse;

Shfrytëzimi efektiv i burimeve, siç janë buxheti, objektet ose pajisjet;

Aftësia për caktimin e objektívave dhe implementumin e tyre;

Aftësitë për zgjdhjen e problemeve, posaçërisht problemeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe materiale.

PJESA III: Shqyrtimi i Raportit nga Komisioni Vlerësues

Në bazë të notimit në Pjesën II nxirret nota mesatare e cilës përbën vlerësimin e përgjithshëm.

Përbledhje e diskutimeve të panelit vlerësues dhe komentet specifike (arsyetimi i notave dhe komentet, pikat e fortë dhe të dobëta, fushat për përmirësimin, etj.)

Rekomandimet e Komisionit Vlerësues (posaçërisht për përmirësimin e Menaxhimit në Shërbimet Prokuroriale):

Kryesuesi i Komisionit Vlerësues:

Data / Emri dhe Mbiemri / Nënshkrimi

Anëtari 1:

Data / Emri dhe Mbiemri / Nënshkrimi

Anëtari 2:

Data / Emri dhe Mbiemri / Nënshkrimi

Anëtari 3:

Data / Emri dhe Mbiemri / Nënshkrimi

Anëtari 4:

Data / Emri dhe Mbiemri / Nënshkrimi

Anëtari 5:

Data / Emri dhe Mbiemri / Nënshkrimi

Anëtari 6:

Data / Emri dhe Mbiemri / Nënshkrimi

Anëtari 7:

Data / Emri dhe Mbiemri / Nënshkrimi

Konfirmimi nga prokurori që i nënshtrohet vlerësimit dhe kundërshtimet

Unë e kam lexuar reportin më lartë dhe kam pranuar një kopje të tij

Komentet nga prokurori që i është nënshtuar vlerësimit:

Data / Emri dhe Mbieni / Nënskrimi (Prokurori që i nënshtrohet vlerësimit)

Komentet:

Kjo shtojcë do të përdoret nga Komisioni Vlerësues gjatë shqyrtimit përfundimtar. Formulazi përmban kërkesat e nevojshme ligjore dhe nënligjore që mundësojnë vlerësimin adekuat dhe është në pajtim me formularin që përdoret nga KGJK për vlerësimin e gjyqtarëve.

Sa i përket disa aspektet që dallojnë, duhet të theksohet se:

- Kriteret e përcaktuara në këtë formular janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligj, ndërsa treguesit e përcaktuar në Rregallorë janë pasqyruar edhe në formular.
- Metodat e vlerësimit që përdoren nga Komisioni i Vlerësimit do të aplikohen përgatimin/notimin e secilit kriter që së bashku paraqesin notën përfundimtare.
- Shtojca nuk përmban ndonjë pjesë për vlerësimin e të dhënave statistikore që konsiderohet se përgatiten nga Njësia.
- Një pjesë e formularit është paraparë shprehimi i përvjetorëve të cilët përvet pozitë së tyre të prokurorit ushtrojnë edhe detyra menaxhueze (Kryeprokurori / Prokurori Mbikëqyrës)
- Tri shtojca janë përgatitur gjithsej për qellime të rregullores përvjetorëve të vlerësimin e prokurorëve dhe qellimi i tyre është që të sigurojnë vlerësimin e plotë të prokurorëve. Secila nga këto shtojca përpinqet të paraqesë një perspektive të ndryshme: nga perspektiva e Kryeprokurorit, nga perspektiva e vetë Prokurorit dhe nga perspektiva e Komisionit Vlerësues të KPK. Megjithëse janë disa pikë të cilat ndërlidhen në këto shtojca, janë bërë përpjekje që të shmanget dyfishimet e panevojshme, posaçenisht sa i përket roli të NJSHP përmbledhjen e të dhënave dhe shifrat statistikore.
- Në përgjithësi, Njësia (NJSHP) është përgjegjëse për aspektet kuantitative: mbledhjen e të dhënave, sigurimin e analizave statistikore, etj. Komisioni Vlerësues duhet të vlerësojë punën e prokurorit nën vlerësim llidhur me punën dhe aftësitë profesionale, cilësinë e punës në kontekstin e përgatitjes së akteve të ndryshme ligjore, si dhe paraqitjen e tyre para gjykatës, respektivisht të gjithë elementet dhe treguesit të cilët nuk janë në kontekst personal ose që i përkasin punës së përditshme që tashmë është vlerësuar nga mbikëqyrësi, etj...
- Përfundimisht, Komisioni përvjetorës i Performance-s së Prokurorëve duhet të martë rol përfundimtar dhe udhëheqës në përbledhjen e të gjitha këtyre vlerësimeve të bëra në bazë të burimeve të ndryshme duke përfshirë edhe analizën e rasteve të zgjedhura, dhe rasteve të propozuara drejtpërdrejt nga Prokurori nën vlerësim.

- Në fund, pa burokraci të panevojshme dhe dyfishim të informacionit, rezultatet e vlerësimit shërbejnë si mjet themelor për menaxhimin e Shërbimeve Prokuroriale. Rezultatet e fituara mundësojnë kryerjen e ndryshimeve dhe reformave që kanë për qëllim tritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e Kosovës.



REPUBLIKA E KOSOVES/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIK OF KOSOVA
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČNI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

SHTOJCA 2

Raporti i vlerësimit vjetor të Prokurorëve
(nga Kryeprokurori)



REPUBLIKA E KOSOVES/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIK OF KOSOVA
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVES/TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

RAPORTI I VLERËSIMIT VJETOR (nga Kryeprokurori)

DosjaNr. _____

Data: _____ / _____ / _____

PJESA I: INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Emri: _____

Data e Lindjes: _____

Pozita / Departamenti _____

Infomata shtesë:

(Pjesëmarrja si trajner, publikimet, kualifikimet akademike, duke përfshirë institucionin përkatës arsimor, data e përfundimit, grada e arritur dhe studimet post-diplomike)

PJESA II: VLERËSIMI NË BAZË TË KRITEREVE DHE TREGUESVE TË PËRCAKTUAR NË RREGULLORE

Kryeprokurorët inkurajohen që të kryejnë vlerësimet në bazë të dokumenteve dhe statistikave origjinale në mënyrë që të sigurojnë saktësinë dhe korrektësinë e informacionit. Vlerësimi duhet të jetë mjaftueshëm detal dhe në formë narrative për secilin tregues veç e veç.

I. Njohuria profesionale, përvoja e punës dhe performanca, duke përfshirë njohjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut

Treguesit:

Aftësia për arsyetimin e kërkesave për caktimin e masave; (paraburgimi, arresti shtëpiak, etj).

Aftësia për iniciimin/pezullimin e hetimeve;

Aftësia për kualifikimin adekuat të veprës penale;

Aftësia për mbrojtjen e rastit para gjykatës; dhe

Përvoja e punës.

II. Kapaciteti dhe aftësia për analizimin e problemeve ligjore dhe zotësia për arsyetim ligjor

Treguesit

Njohja e ligjeve të aplikueshme.

Aftësia për kualifikimin e veprave penale në mënyrë adekuate;

Aftësia për përfshirjen e fakteve sipas dispozitave përkatëse;

Aftësia për analizimin e ligjeve sipas metodave sistematike dhe koherente

Kapaciteti për grumbullimin e provave/fakteve sipas implikimeve ligjore;

Kapaciteti për vlerësimin dhe arsyetimin e provave të grumbulluara lidhur me veprën penale.

III. Aftësia profesionale

Treguesit:

Vetiniciativa;

Puna ekipore;

Aftësia për menaxhimin e rasteve dhe kohës;

Shkathësia e marrjes ne pyetje (drejtpërdrejtë dhe tërthorte);

Përdorimi i teknologjisë informative;

Personaliteti i fortë dhe vetë-kontrolli;

Gatishmëria për te zhvilluar shkathësitë profesionale përmes trajnimeve;

Pjesëmarja në aktivitete tjera (tryeza pune, grupe punuese, etj.)

Gatishmëria për zëvendësimin e prokurorëve tjerë;

Kapaciteti përmarrjen e iniciativës në rastet e tjera kur vepron si prokuror zëvendësues; dhe

Gatishmëria përmarrje përmarrje ne Kujdestari(si prokuror "Kujdestar").

IV. Aftësia përmarrjen e detyrave në mënyrë të paanshme, me zell, vendosmëri dhe përgjegjësi

Treguesit:

Pavarësia dhe paanshmëria;

Ndershmëria, sinqeriteti dhe besueshmëria;

Sjelja e mirë dhe karakteri

Fuqia e personalitetit dhe vetëkontrolli;

Respektimi i Kodit të Etikës

V. Aftësitë e komunikimit

Treguesit

Aftësia përmarrjen e saktësisë, qartësisë dhe njëtra/tshmërisë në dokumentet e shkruara.

Aftësia përmarrjen e faktave në sëancën dëgjimore dhe përmarrjen e shqyrtimeve në seancën gjyqësore.

Aftësia për ndërveprimin me publikun dhe palët në procedure në mënyrë profesionale
dhe të sjellshme.

VI. Sjelljet jashtë zyrës

Treguesit:

Respektimi i standardeve të sjelljes brenda dhe jashtë zyrës për aq sa ndikon në
veprimtarinë profesionale të prokurorit.

Vlerësimi i aktiviteteve plotësuese,

Vlerësimi i konflikteve eventuale të interesit.

VII. Integriteti personal

Treguesit

Dinjiteti, sinjeriteti, besueshmëria;

Respektimi i diversitetit

Pershtatshmeria

PJESA III: VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

1. Lista e burimeve të informacionit të përdorura për vlerësimin

2. Opinion i Prokurorit Mbikëqyrës

3. Analiza

(Justifikimet dhe komentet lidhur me të gjithë treguesit, d.m.th pikat e forta dhe të dobëta, fushat për përmirësime, propozimet për rekomandime, etj.)

Kryeprokurori

Data/Emri/Nënshkrimi

Komentet:

Në aspekt strukturor, të gjitha vlerësimet e performancës së prokurorëve duhet të jenë të drejta dhe jo-diskriminuese; këto synime realizohen vetëm përmes objektivitetit të kritereve dhe përcaktimit paraprak të burimeve të informacionit.

Qellimi kryesor i vlerësimit nga Kryeprokurori ka të bëjë me çështjet cilësore të performancës së Prokurorit nën vlerësim.

Në përgjithësi, Njësia (NJSHP) është përgjegjëse për aspektet kuantitative: mbledhjen e të dhënavë, sigurimin e analizave statistikore, etj. Kryeprokurori duhet të vlerësojë punën e prokurorit nën vlerësim në bazë ditore, mënyrën e komunikimit të tij/saj me publikun dhe palët, sjelljen brenda dhe jashtë zyrës dhe respektimin e rregullave të etikës dhe Kodit të Etikës, kapacitetin për zgjidhjen e problemeve konkrete ditore dhe në kontekste dhe rrëthana të ndryshme, etj...

Përfundimisht, Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve duhet të marrë rol përfundimtar dhe udhëheqës në përbledhjen e të gjitha këtyre vlerësimeve të bëra në bazë të burimeve të ndryshme duke përfshirë edhe analizën e rasteve të zgjedhura dhe rasteve të propozuara drejtpërdrejt nga Prokurori nën vlerësim.

Në fund, pa burokraci të panevojshme dhe dyfishim të informacionit, rezultatet e vlerësimit shërbejnë si mjet themelor për menaxhimin e Shërbimeve Prokuroriale. Rezultatet e fituara mundësojnë kryerjen e ndryshimeve dhe reformave që kanë për qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e Kosovës.



REPUBLIKA E KOSOVES/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIK OF KOSOVA
KESHILLI PROKURORIAL I KOSOVES/TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

SHTOJCA 3

Formulari për Vetëvlerësim
(nga Prokurori)



REPUBLIKA E KOSOVES/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KESHILLI PROKURORIAL I KOSOVES/TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

Dosja Nr. _____

Data: ____ / ____ / ____

PJESA I: INFORMATAT TË PËRGJITHSHME

Emri: _____

Data e Lindjes: _____

Pozita/Departamenti: _____

1. PËRVOJA E PUNËS

(Funkcionet gjyqësore dhe periudhat përkatëse duke përfshirë informatat plotësuese lidhur me veprimet e kryera, etj.)

2. EDUKIMI, TRAJNIMET, KUALIFIKIMET

Aktivitetet relevante

(pjesëmarrja si trajner, publikimet, kualifikimet akademike, duke përfshirë institucionin përkates arsimor, datat e përfundimit, grada e arritur dhe studimet post-diplomike), pjesëmarrja në konferenca, trajnime, aktivitetet shoqërore, etj.)

PJESA II: VLERËSIMI I PERFORMANCES

Prokurori duhet të bëjë një vetë-vlerësim të drejtpërdrejtë dhe të sigurojë informata të hollësishme për secilën pyetje veç e veç.

1. Si e vlerësoni performancën e juaj gjatë kësaj periudhe?

2. A mendoni se e keni plotësuar normën sipas Udhëzimit Administrativ të KPK për përcaktimin e normës vjetore për Prokurorë duke marrë parasysh natyrën e rasteve? (ju lutem arsyetonit deklaratën e juaj)

3. A mendoni se gjatë procedurës jeni ballafaquar me një rast të vështirë që ka marrë shumë kohë përvendosje në krahasim me rastet tjera? Nëse po, cili rast (ju lutem shpjegoni)?

4. A mendoni se i keni respektuar afatet kohore për hartimin e kallëzimeve penale / kryerjen e hetimeve
dhe afateve tjera ligjore? (ju lutem ofroni fakte dhe arsyel)

5. A mendoni se keni vëndosur për rastet sipas renditjes së pranimit të tyre, pavarësisht nga pasha,
rëndësia dhe kompleksiteti? (ju lutem arsyetonit deklaratën e juaj!)

6. Informatat dhe/ose komentet tjera që ju mendoni se janë relevante për vlerësimin.

PJESA III: RASTET E DORËZUARA

Unë propozoj tetë rastet e bashkëngitura në vijim, të përgatitura gjatë periudhës së vlerësimit për
përdorim gjatë vlerësimit (ju lutem referojuni datës së vendimit dhe numrit të lëndës):

Data / Emri dhe Mbiemri / Nënskrimi
(Prokurori nën vlerësim)

Komentet:

Kjo shtojcë është përgatitur sipas detyrave specifike të Prokurorëve. Megjithatë, gjithashtu është bërë harmonizimi me procesin e vetë-vlerësimit të gjyqtarëve në mënyrë që t krijohet një komizë koherente.

Sa i përket disa aspekteve të veçanta të pëkavë të ndryshme, duhet të theksohet si vijon:

- Referencia në Funksionet Gjyqësore (Pjesa I – Pjetja I) përfshin spektrin e gjërë të aktiviteteve që mund të ushtronhen gjatë karrierës së prokurorit, duke marrë parasysh gjithashtu përvojën paraprake në sistemin gjyqësor;
- Pjetjet lidhur me performancës e prokurorit të vlerësuat i lejojnë atij që të jepë perspektivën personale lidhur me kuantitetin e punës së arritur si dhe kompleksitetin dhe natyrën e lëndëve të besuara.
- Është opsion për definimin e numrit të lëndëve që dorëzohen nga Prokuroti i cili kryen vetë-vlerësimin. Propozimi i tetë rasteve (ngjashëm me gjyqtarët) nuk është i detynueshëm dhe mund të shqyrtohet edhe ndonjë opsion tjeter.
- Gjithashtu duhet të theksohet fakti se Prokurorit nën vlerësim i është dhënë mundësia që të paraqesë jo vetëm kalëzimet penale por edhe dokumentet tjera të shkruara që janë përgatitur nga ai/ajo. Në këtë mënyrë i lejohet Prokurorit që të paraqesë një vetë-vlerësim më të zgjeruar duke i dhënë kështu më shumë mundësi për vlerësim të saktë nga KPK.
- Tri shtojca janë përgatitur gjithsej për qëllime të rregullores për vlerësimin e prokurorëve dhe qëllimi i tyre është që të sigurojnë vlerësimin e plotë të prokurorëve. Secila nga këto shtojca përpinqet të paraqesë një perspektive të ndryshme; nga perspektiva e Kryeprokurorit, nga perspektiva e vetë Prokurorit dhe nga perspektiva e Komisionit Vlerësues të KPK. Megjithëse janë disa pikë të cilat ndërlidhen në këto shtojca, janë bërë përpjekje që të shmangen dyfishimet e panevojshme, posaçërisht sa i përket rolit të NJSHPP për mbledhjen e të dhënave dhe shifrave statistikore..